



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:095637

Datë: 13.11.2020

Numri i dokumentit: 01271510

**PKR.nr.547/2020**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**, në përbërje nga kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Naser Foniqi, me sekretaren juridike **Sevdije Breznica**, si procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit A. K., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374, par. 1, të Kodit Nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës – në vijim KPRK, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda **PP.II.nr.6497/2017, të datës 28.03.2018**, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 12.11.2020, në të cilin ish-in të pranishëm prokurori i shtetit **Fitore Sadikaj dhe** i akuzuari A. K., të njëjtën ditë, me datë 12.11.2020, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari A. K.**, i biri i Z. dhe H., e vajzërisë S., i lindur me datë ....., në fshatin G., Komuna P., ku edhe jeton, me numër personal ....., ka të kryer shkollën fillore, i martuar-baba i dy fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

**S e p s e:** me datë 02.09.2017, rreth orës 21:52, në fshatin Llukarë, Komuna Prishtinë, u i pandehuri është ndaluar nga Policia e Kosovës për një kontroll, atij i janë gjetur në posedim 49 fishekë të kalibrit 7.62 mm, ndërsa në shtëpinë e tij i është gjetur pushka automatike e prodhimit kinez me numër serik 3114274, në posedim të pa autorizuar dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për posedimin apo shfrytëzimin e armëve të tilla,-

- me këtë, ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374, par. 1, të KPRK.
- Prandaj, gjykata në bazë të neneve: 49; 50; 51; 52; 73 dhe 374, par. 1 dhe 3, të KPRK, si dhe nenit 365, të KPP, të akuzuarit i shqipton:

**DËNIM ME GJOBË ME KUSHT**

- **Në shumë prej një mijë (1000) €**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftë se brenda afatit prej **një (1) viti**, i akuzuari nuk do të kryej veprë të re penale.

- Obligohet i akuzuari që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare, **ndërsa në emër të paushallit gjyqësor duhet të paguaj shumën prej tridhjetë (30) €**, në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- Të akuzuarit i konfiskohet arma – pushka automatike e prodhimit kinez me numër serik 3114274 dhe 49 fishekë të kalibrit 7.62 mm, e cila është si rezultat i kryerjes së veprës penale.

## ARSYETIMI

Pas kallëzimit penal të Policisë së Kosovës/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Prishtinë nr.2017-AC-1180, të datës 25.10.2017, Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën **PP.II.nr.6497/2017, të datës 28.03.2018**, e ka akuzuar të pandehurin A. K., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374, par. 1, të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 12.11.2020, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari A. K., ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, si dhe ka shtuar se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit dhe këtë pranim e ka bërë vullnetarisht. Po ashtu, i akuzuari ka thënë se i vjen shumë keq që i është gjetur kjo armë, për të cilën k thënë se nuk ka pasur njohuri për rëndësinë e saj pasi ai jeton në fshat - në mal dhe se absolutisht asnjëherë asgjë të keqe nuk i ka bërë askujt me këtë armë. Pastaj, i akuzuari ka theksuar se nëse gjykata e shpall fajtor ka kërkuar një dënim më të lehtë duke pasur parasysh gjendjen e tij ekonomike, pasi ai kohë pas kohe punon si punëtor krahu dhe me ato para që merr rreth 50-60 euro në muaj mban familjen e tij prej gjashtë anëtarësh, nga të cilët asnjëri nuk ka një punë të rregullt, përkatësisht jeton me nënën, bashkëshorten, dy fëmijët dhe vëllain e tij, në gjendje të rëndë ekonomike pa ndonjë ndihmë nga shteti.

Sa i përket pranimin të fajësisë nga i akuzuari, prokurori i shtetit, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi ky pranim është bërë në bazë të vullnetit të tij të lirë dhe në përputhshmëri me dispozitën e nenit 248 të KPPK, e po ashtu, ky pranim është në përputhshmëri të plotë me provat dhe faktet që gjenden në shkresat e lëndës, me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale. Andaj, prokurori i shtetit i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

Pas deklarimit të akuzuarit se ndihet fajtorë për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar nga Prokuroria, kryetari i trupit gjykues me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, si dhe është mbështetur në faktet që përmban aktakuza, e cila nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore e as gabime faktike.

Po ashtu, edhe nga shkresat e lëndës përkatësisht: deklarata e të akuzuarit A. K., dhënë në polici me datë 02.09.2017; deklarata e dëshmitarit G. K., dhënë në polici me datë 02.09.2017; vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve nr.2017-AC-1180, të datës 02.09.2017 dhe fotografitë e armës së sekuestruar, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprave penale për të cilën është akuzuar, si dhe vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtor të akuzuarin, pasi më parë gjeti se është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si: sinqeritetin e treguar gjatë shqyrtimit; pranimin e fajit për veprën e kryer penale dhe gjendjen e tij ekonomike, përkatësisht i njëjti është i pa punë dhe familja e tij e sigurojnë ekzistencën nga mjetet që ua i dërgon vëllai i tij nga Gjermania, ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese, prandaj të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar atij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41, të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëj rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Në këtë rast, gjykata është bazuar edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, për një proces të hapur dhe të rregullt, që çdo person i akuzuar ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, duke pasur parasysh edhe bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij, si dhe në parimin që çdo person i akuzuar për një veprë penale të prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Vendimi që të pandehurit t'i merret sendi i përdorur për kryerjen e veprës penale, u mor në bazë të nenit 374, par. 3, të KPK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 1, të KPPK.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të neneve: 374, par. 1 dhe 3 të KPRK dhe 365, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë **13.11.2020**.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA  
PKR.nr.547/2020, datë 12.11.2020.

Sekretare juridike,  
**Sevdije Breznica**

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari,  
Naser Foniqi

#### **UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.